



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 1055 Prot.

Tiranë, më 25.07.2019

Lënda: Njoftim

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.483, datë 10.7.2019 “*Për disa ndryshime ne Vendimin Nr. 16, date 16.1.2019 “Per përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2018 në njësitë e qeverisjes qendrore”*” shpall kërkesën për punonjës me kontratë të përkohshme, me kohëzgjatje deri në 31 Dhjetor 2019, me kohë pune 8 orë në ditë për sa më poshtë:

I – Pozicionet

- Punonjës arkive 5 persona

II – Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët:

- Kërkesën për aplikim;
- Curriculum Vitae të përditësuar, modeli Europass, me datën dhe firmën e personit;
- Fotokopje të pashaportës ose kartës së identitetit;
- Fotokopje të diplomës;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj
- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore
- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;

Dokumentacioni i mësipërm duhet sjellë pranë zyrave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit, në adresen; Rr.”Ibrahim Rugova”, Garda e Republikës, brenda datës 29.7.2019.

III - Kërkesat që duhet të plotësojnë kandidatët:

- Të kenë përfunduar studimet e larta (bachelor), preferohet në degën histori/arkivistikë;
- Të kenë përvojë pune në sekretari/protokoll/arkiv, ose eksperiencë të ngjashme
- Të kenë njohuri shumë të mira mbi sistemin Windows dhe programet MS Office;
- Të jenë të aftë dhe të gatshëm për të punuar në grup, dhe të përballen me detyrat e punës nën presion
- Përvoja e punës në administratën shtetërore përbën avantazh.

IV – Përzgjedhja e kandidatëve:

- Përzgjedhja fillestare e kandidatëve do të bëhet mbi bazën e dokumentave të paraqitura brenda datës 30.7.2019;
- Të gjithë kandidatët do të njoftohen me email për rezultatet e përzgjedhjes brenda datës 30.7.2019;
- Kandidatët e përzgjedhur nga faza e mësipërme do të nënshtrohen një interviste me gojë, brenda datës 31.7.2019;
- Kandidatët fitues do të njoftohen me email, për të vazhduar me kompletimin e dokumentacionit dhe nënshkrimin e kontratës të punës (bazura në Kodfin e Punës) brenda datës 31.7.2019.

